

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur nenit 13, të Rregullores Nr. 01-110/04-14194, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim për më pak se një (1) të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Raportit final të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës së Gjakovës lidh këtë:

K O N T R A T Ë

Për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës së Gjakovës

E hartuar me datë ____07.2022 në Gjakovë, lidhur në mes të palëve kontraktuese, si më poshtë:

PALËT KONTRAKTUESE:

- 1. Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Gjakovës i cili e përfaqëson Komunën**, si dhënës i pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim për më pak se një (1) vit nga njëra anë dhe
- 2. Flurim Kurti** – përfaqësues i biznesit “Flurim Kurti” B.I, nga Komuna e Gjakovës, Rr. “Avni Rustemi” nr.30, me numër të biznesit 810243874, përfitues - shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës, nga ana tjetër.

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, e pronës së paluajtshme të Komunës së Gjakovës, për shfrytëzimin e hapësirës publike para lokalit afarist, për vendosjen e mbulesës më qëllim të shfrytëzimit për vendosjen e produkteve metalike për tregti, me sipërfaqe prej 12.40 m² në hapësirën publike në pjesë të parcelës e evidentuar me numër 03340-0, P.SH Rrugët Publike, Z. K Gjakovë - Qytet, sipas kërkesës së prezantuar nga pala.

Neni 2
Kohëzgjatja e kontratës

Palët kontraktuese janë pajtuar që afati i shfrytëzimit të hapësirës së lartcekur të jetë nga data 01.08.2022 deri me datë 30.06.2023.

$$\frac{1}{10} \times 100 = 10\%$$

Lartësia e çmimit dhe afati i pagesës

- $$\frac{1}{10} \times 100 = 10\%$$

Dhënia e pronës së paluajtshme dhe mënyra e shfrytëzimit

- $$\frac{1}{10} \times 100 = 10\%$$

Mbikëqyrja e kontratës

- $$\frac{1}{10} \times 100 = 10\%$$

Neni 6
Shkëputja e njëanshme e kontratës

1. Shkëputja e kontratës në mënyrë të njëanshme bëhet në rast të mospërbushjes së obligimeve, nga shfrytëzuesi i pronës së paluajtshme, siç është përcaktuar në këtë kontratë.
2. Komuna e Gjakovës ka të drejtë që të shkëpusë kontratën para kalimit të afatit të caktuar, në rast kur i nevojitet hapësira e dhënë në shfrytëzim për investime apo për realizimin e ndonjë projekti të caktuar.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj kontrate dhe në rast të mosmarrëveshjes eventuale ndërmjet palëve kontraktuese, palët do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore. Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje në mes të palëve, atëherë kontesti do të zgjidhet në Gjykatën kompetente.


Neni 8
Kopja e kontratës

Kjo kontratë është përpiluar dhe nënshkruar në 3, (tri) kopje të njëjta identike prej të cilave nga 1, (një) kopje i takon secilës palë kontraktuese, kurse (1) një Drejtorinë përkatëse.


Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

PALËT NËN SHKRUESE

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Flurim Kurti

Flurim Kurti B.I.

